

KONTRATË SHIT-BLERJE

(KUOTASH)

Në Tiranë, sot, më datë 25/11/2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë), hartohet dhe nënshkruhet kjo kontratë ndërmjet palëve të mëposhtme:

SHITËSI: **Herjeta Deliaj**, e bija e Hekuran-it, lindur në Tiranë, më 24.03.1983, dhe banuese në adresën: Rr. Irfan Tomini, Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me letënjoftimin me nr.031369996 dhe nr.personal I35324150H,

BLERËSI: **Koço KOKËDHIMA**, i biri i Theodor, lindur në Qeparo, Vlorë, më 21/04/1959, dhe banues në adresën: Rr. Ismail Qemali, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin me nr.028976599 dhe nr.personal F90421072M.

Kushte të Përgjithshme

- A.** Shoqëria “2K Group”shpk është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS: J82221005L.
- B.** Shitësi deklaron se zotëron 9,000 (nëntëmijë) kuota, të kapitalit të shoqërisë “2K Group”shpk, të barasvlefshme me 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë.
- C.** Shitësi dëshiron t’i shesë Blerësit, dhe Blerësi dëshiron të blejë 9,000 (nëntëmijë) kuotat që Shitësi zotëron në shoqëri, të cilat përfaqësojnë 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë “2K Group”shpk.
- D.** Në përputhje me statutin e shoqërisë “2K Group”shpk, nenin 73 “Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave”, pika “b” të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, nenin 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, hartohet kontrata e shitjes së kuotave me kushtet si më poshtë vijon:



Neni 1

Objekti i kontratës

Shitja dhe Blerja e Kuotave

- 1.1 Me anë të kësaj kontrate, Shitësi i kalon Blerësit titullin e pronësisë të 9,000 (nëntëmijë) kuotave, të cilat përfaqësojnë 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "2K Group" shpk. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me kuotat në fjalë ndjekin kuotat dhe kalojnë gjithashtu në pronësi të Blerësit.

Kalimi i Pronësisë së Ligjshme mbi Kuotat

- 1.2 Blerësi do të bëhet zotërues me të drejta të plota të kuotave të blera në kapitalin e shoqërisë "2K Group" shpk, menjëherë, me nënshkrimin e kësaj kontrate nga të dyja palët.

Neni 2

Çmimi dhe Pagesa

- 2.1 Çmimi i shitjes që Blerësi do t'i paguajë Shitësit për shitjen e kuotave është 3,000,000 (tre milionë) Lekë, çmim, i cili do të paguhet nga Blerësi në një nga mënyrat e njohura nga ligji.

Neni 3

Të drejtat dhe detyrimet e Shitësit

Shitësi deklaron dhe garanton se:

- 3.1 Shitësi është pronar i vetëm dhe i ligjshëm i kuotave që transferon tek Blerësi, dhe ka të drejtë të lidhë këtë kontratë shitblerje kuotash si dhe të përmbushë detyrimet që rrjedhin prej saj.
- 3.2 Shitësi garanton Blerësin nga çdo pretendim që të tretët mund të kenë në lidhje me kuotat, objekt të kësaj kontrate.

Neni 4


Të drejtat dhe detyrimet e Blerësit

- 4.1 Blerësi garanton se ka të drejtë të lidhë këtë kontratë shitblerje të kuotave dhe të përmbushë detyrimet që rrjedhin prej saj.

Neni 5

Të ndryshme

- 5.1 Pavlefshmëria: Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është e pavlefshme, kjo pavlefshmëri nuk prek vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj kontrate. Kushti i pavlefshëm në këtë rast, do të zëvendësohet me një të vlefshëm, i cili do t'i përkojë sa më shumë të jetë e mundur qëllimeve të palëve.



- 5.2 Ligji i zbatuar: Kjo Kontratë bazohet në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr.9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.
- 5.3 Mosmarrëveshjet: Çdo mosmarrëveshje që mund dhe/ose rrjedh nga interpretimi, zbatimi, kryerja, shkelja ose përfundimi i kësaj Kontrate, do të zgjidhet nga Gjykata kompetente.
- 5.4 Gjuha e kontratës: Kjo kontratë është hartuar në 2 kopje origjinale në gjuhën Shqipe.

PALËT

SHITËSI

BLERËSI

Herjeta DELIAJ

KOÇO KOKËDHIMA

